



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 784 Prot.

Tiranë, më 26. 12. 2019

Raport i aktivitetit të
Qendrës Kombëtare të Kinematografisë
për periudhën kohore Janar- Dhjetor 2019

Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit dhe misionit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK)

QKK është institucion qendror, që ushtron aktivitetin në zbatim të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë” të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të zbatim të tij. Misioni kryesor i QKK është financimi dhe promovimi i prodhimit kinematografik në Shqipëri, nëpërmjet administrimit të fondeve publike, me qëllim zhvillimin e industrisë së filmit në vendin tonë.

QKK, që prej krijimit të saj, mbështet prodhimin, distribuimin dhe promovimin e filmave me metrazh të gjatë, të shkurtër, dokumentarë dhe të animuar. Nëpërmjet financimeve prioritet i jepet projekteve që garantojnë bashkëprodhime, kryesisht atyre ndërkombëtare. Kjo është një strategji efikase për të siguruar distribucion dhe audiencë për filmat edhe jashtë vendit.

1. Problematikat gjatë vitit të parë të detyrës të kryetarit të QKK

QKK, nën mandatin e kryetarit të ri, filloi punë tetë muaj më parë, duke e gjetur institucionin të bllokuar prej më se një viti e gjysmë, pasi mandati i kryetarit të mëparshëm nuk ishte rinovuar, dhe Këshillit Miratues të Projekteve (KMP) ekzistues i kishte mbaruar mandati.

Kësaj gjëndjeje i ishin shtuar dhe mosmarrëveshjet egjistuese të QKK-së me shoqatat e kineastëve, të cilat kishin bllokuar krijimin e KMP-së së re, duke përdorur kompetencat që u jepte “*Ligji mbi Kinematografinë*”. Për rrjedhojë kishte shumë projekte kinematografike të akumuluar, të pa financuara.

Me marrjen e detyrës së Kryetarit, QKK veproi me vendosmëri dhe shpejtësi, duke zbatuar ligjin ekzistues “*Mbi Kinematografinë*”, duke bërë marrëveshjen me shoqatat e kineastëve, pavarësisht kundërshtimeve, dhe me shumicë absolute votash nënshkroi një marrëveshje me to.

Pas marrëveshjes QKK organizoi dhe drejtoi punën për krijimin e KMP-së së re prej 5 anëtarësh, 3 (tre) prej të cilëve të huaj dhe 2 (dy) shqiptarë. QKK organizoi dhe drejtoi punët administrative për mbledhjet e KMP-së së re për analizimin, klasifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve më cilësore.

Kjo u bë e mundur nëpërmjet aplikimit të një sistemi pikësimi prej 100 pikësh, të ngjashëm me sistemet e pikësimit që përdoren në Eurimages dhe Kanada. Kjo metodë e re, bëri të mundur analizimin në mënyrë më të saktë dhe profesionale të projekteve, për të filtruar ato më cilësoret.

Mbi bazë të klasifikimit të mësipërm, u financuan vetëm projektet më cilësore. Nga ana tjetër, për secilin prej projekteve fituese u rrit fondi i financimit. Në këtë mënyrë u realizua një pikë tjetër e platformës së kryetarit të ri, e cila parashikonte që me një strategji më të saktë, të rritej financimi për projektet kinematografike, gjë që u realizua me sukses.

Skemat e financimit për projektet kinematografike që aplikohen në QKK janë:

- Filma artistikë të metrazhit të gjatë
- Filma artistikë të metrazhit të gjatë - vepër e parë
- Filma artistike të metrazhit të shkurtër
- Filma dokumentarë
- Filma te animuar

2. Në vitin 2019, pas procesit të vlerësimit fitojnë të drejtën për financim këto projekte:

- 4 Filma me metrazh të gjatë
- 2 Filma me metrazh të gjatë - Vepër e Parë
- 5 Filma me metrazh të gjatë - Minority Coproduction
- 8 Filma me metrazh të shkurtër
- 6 Filma dokumentarë
- 3 Filma me metrazh të gjatë për zhvillim
- 1 Film me metrazh të gjatë, vepër e parë për distribucion & promocion

Ndërkohë u ruajtën e rinovuan të gjitha antarësitë egzistuese. QKK është përfaqësues Shqipërinë pranë strukturave ndërkombëtare kinematografike si Eurimages, SEE, European Film Promotion, Creative Europe.

3. Inisiativat në fushën e kinematografisë për periudhën janar - dhjetor 2019.

- I. U pa e domosdoshme të ndryshohet “*Ligji mbi Kinematografinë*” për të reflektuar ndryshimet e sotme, si dhe për të lejuar taksimin e subjekteve të ndryshme të platformave dixhitale, në mënyrë që të rritet buxheti i QKK nga burime alternative.

Me urdhër të Ministres së Kulturës është ngritur grupi i punës për ndryshimin e Ligjit.

- II. U kristalizua ideja midis QKK-së së Shqipërisë dhe Qendres Kinematografike të Kosovës për zhvillimin e Festivalit Mbarëkombëtar të Filmit Shqiptar në 2020. Për këtë janë ngritur komisionet e punës.

4. Inisiativat në aspektin e bashkëpunimit rajonal

- a. Me inisiativën e QKK, u miratua në Këshillin e Ministrave Konventa e Ndryshuar Evropiane e Bashkëprodhimeve Kinematografike. Pritet miratimi në Parlament.
- b. Marrëveshja përsa i përket bashkëprodhimeve kinematografike me Kosovën. Është dërguar për miratim në Ministrinë e Kulturës.
- c. Nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit midis CNC-së, Francë dhe QKK në janar 2020.
- d. Krijimi i “BALKANIMAGE” (me propozim të QKK) dhe përkrahje nga të gjitha shtetet e rajonit. Në këtë partneritet merr pjesë dhe Italia si një partner aktiv.

5. Planet për 2020

- a. Të sigurohet vazhdimësia e financimit të fazave të mëvonshme të projekteve si dhe aktiviteti normal i QKK. Kjo përfshin dhe përkrahjen e grupeve të huaja që do të vijnë të xhirojnë në Shqipëri. (Janar – Dhjetor 2020).
- b. Të vihet në funksionim **faza e zhvillimit të projekteve** për të gjithë projektet në mënyrë të detyrueshme, duke përgatitur të gjithë procesin, si nga ana ligjore ashtu dhe nga ana juridike (deri në fund të Janarit).
- c. Të përfundojë faza e konsultimeve juridike me specialistët e huaj dhe ndryshimet e paketës ligjore të përmirësimit të “*Ligjit mbi Kinematografinë*” dhe të përcillet për miratim në instancat përkatëse. Këtu përfshihet dhe incentiva për *Cash Rebate (mesi i vitit 2020)*.
- d. Të zhvillohet Festivali Mbarëkombëtar i Filmit Shqiptar.

6. Përsa i përket marrëdhënieve me jashtë:

- I. Të miratohet në Parlament Konventa e Ratifikuar e Bashkëprodhimeve Kinematografike Evropiane (Janar 2020).

- II. Të krijohet zyrtarisht “BALKANIMAGE”, duke u miratuar përfundimisht si në aspektin juridik ashtu dhe në atë ekonomik formula e tij, në bashkëpunim me të gjitha shtetet e tjera pjesëmarrëse si dhe partnerëve të tjerë të mundshëm. (Janar – Dhjetor 2020)

7. Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka zhvilluar këto aktivitete gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019

7.1 Premiera Filmash:

Janë përfunduar dhe kanë realizuar premierat për publikun projektet filmike, si më poshtë vijon:

Filma artistikë metrazh të gjatë:

- **Inane** - skenari dhe regjia Besnik Bisha
- **Bolero në vilën e pleqve** - skenari Linda Fejzaj, regjia Spartak Pecani
- **Portreti i pambaruar** - skenari Ruzhdi Pulaha, regjia Namik Ajazi
- **Love** - skenari Irvin Mucaj & Dionis Papadimitri, regjia Dionis Papadimitri
- **Liqeni im** - skenari dhe regjia Gjergj Xhuvani
- **Derë e hapur** - skenari Ajola Daja & Florenc Papas, regjia Florenc Papas

Filma në kategorinë minority co-production:

- **Nëntori i ftohtë** - skenari dhe regjia Ismet Sijarina
- **Shpia e Agës** – skenari dhe regjia Lendita Zeqiri
- **Fusha e mëllenjave** – skenari dhe regjia Arzana Kraja
- **Zana** – skenari dhe regjia Antoneta Kastrati
- **Pranverë e paharruar në fshatin e harruar** – skenari dhe regjia Kushtrim Bekteshi

Filma artistikë me metrazh të shkurtër:

- **Rrëfimet e një vrasësi me pagesë** - skenari Vladimir Prifti, regjia Klajd Papadimitri
- **Lajmi** - skenari Anila Balla & Lorin Terezi, regjia Lorin Terezi
- **Kllouni** - skenari dhe regjia Edmond Mandro
- **Vulë** - skenari dhe regjia Valmir Tërtini
- **Rrugës** - skenari dhe regjia Irdit Kaso

Filma dokumentarë:

- **Njeriu me këmishë** - skenari Luan Kryeziu, regjia Luan Kryeziu dhe Endrit Delisula

- **La Madonna di Scutari** - skenari dhe regjia Fabian Kati

Filma të animuar:

- **Aventurat e Lelos-Labirinthi**- skenari Marius Gace, regjia Endrit Beqo
- **Macja** – skenari dhe regjia Artur Dauti

7.2 Financime të QKK në festivale filmi (kombëtare dhe ndërkombëtare):

7.2.1. Festivale ndërkombëtare brenda vendit gjatë vitit 2019:

- Festivali Ndërkombëtar i Filmit “TIFF”, Tiranë, Shtator.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut, Shtator.
- Balkan Film Market, Edicioni i III, Tiranë, Tetor.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit dhe Kulinarisë, Pogradec, Tetor.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit për Studentë dhe Rinj “First Film Step On Tour”, Tetor.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit “A-Film Fest - Rozafa”, Nëntor Shkodër.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit “48-orëshi film project Tirana”, Tiranë, Dhjetor.

7.2.2 Festivale ndërkombëtare jashtë vendit 2019:

- Festivali i Filmit në Berlin, Shkurt.
- Festivali i Filmit në Kanë, Maj.
- Festivali i Filmit në Prishtinë, Korrik.
- Festivali i Filmit në Sarajevë, Korrik ku kineastët shqiptarë morën pjesë në premierën botërore të filmit “Derë e hapur”, të regjisorit Florenc Papas.

Gjithashtu, gjatë këtij aktiviteti u organizua takimi i drejtuesve të institucioneve që operojnë në fushën e audiovizualit.

7.3 Aktivitete të tjera ndërkombëtare:

- a) Stenda e kinematografisë shqiptare në Festivalin e Filmit në Berlin.
- b) Stenda e kinematografisë shqiptare në Festivalin e Filmit në Kanë.
- c) Pjesëmarrja e përfaqësuesve të QKK në mbledhjen e rradhës së SEE mbajtur gjatë Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Selanik, Greqi;

- d) Festivali i filmit “SEANEMA”, Ulqin; mbledhjet e Eurimages; takimi i EFP; etj.
- e) Ditët e kinemasë shqiptare në Romë.
- f) Pjesëmarrje në takimin e rradhës në Casacalenda, Itali për projektin CIRCE “Interreg IPA CBC, Italy-Albania-Montenegro”.

7.4 Projekte të ndryshme për vitin 2019:

- I. Organizimi në Tiranë (28-29 tetor) i takimit të tretë CIRCE “Interreg IPA CBC, Italy-Albania-Montenegro”, event ky i mbështetur nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe Creative Europe - Media Desk Shqipëri.

Nga thirrja e organizuar nga CIRCE në korrik 2019 në Molise, Itali, ndër 9 fituesit e saj, 4 prej tyre ishin autorë nga Shqipëria: Jonid Jorgji, Ergys Meta, Benart Laze dhe Mentor Selmani.

- II. Financimi i botimit të librit “*Ulliri- Pema e dhimbjes*” të Dhimitër Anagnosti.

FONDE ALTERNATIVE TË SIGURUARA GJATË VITIT 2019:

1. Nëpërmjet programit *Interreg IPA Cross-border Cooperation Programme "Italy-Albania-Montenegro"* u gjetën fondet alternative për realizimin e projektit pilot (një nismë që kjo prej vitit 2015) për hapjen e kinemave fillimisht në qytetin e Gjirokastrës dhe Vlorës për të vazhduar më tej në qytete të tjera të Shqipërisë si Pogradec, Shkodër, Sarandë, etj. dhe sigurimin e mjeteve teknike për funksionimin e tyre.
2. Janë financuar nga Eurimages 2 projekte filmike të metrazhit të gjatë të kategorisë Minority Co-Production.
3. Janë financuar nga SEE Cinema Network 3 projekte filmike (një me metrazh të gjatë dhe dy me metrazh të shkurtër)
4. Është financuar nga Creative Europe/Media Desk një projekt kinematografik i regjisorit Gentian Koci (Zhvillim projekti).

Çfarë do bëhet gjatë 2020

Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë po punojmë për implementimin e një skeme të re financimi për realizimin e mbështetjes për produksionet e huaja që duan të realizojnë xhirimet në territorin shqiptar (sipas skemës Cash Rebate).

- Mbledhja e perfaqësuesve të qendrave të filmit të Ballkanit për krijimin e një fondi të përbashkët për financimin e projekteve filmike europiane, nën patronazhin e Qendrës Audiovisuale të Italisë.
- Festivali Mbarëkombëtar Shqiptar i Filmit në bashkëpunim me Qendrën Kinematografike të Kosovës.

7.5 Detyra funksionale (administrative)

- Ngritja e Komisionit Përzgjedhës të Filmit për OSCAR.

7.6 Plan Buxheti

Buxheti për vitin 2019, në total 179,620,000 lekë, prej të cilave:

- mbështetje ekonomike për projektet kinematografike 136,220,000 lekë;
- investime 1,000,000 lekë.

7.7 Të ardhurat

Të ardhurat dytësore janë realizuar 1,700,000 lekë, të cilat derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

Eduart MAKRI

